



INTERNEWS KOSOVA  
Nr. 17-05-1684 Dt. 04.05.2017

**kallxo**

# Memorandum i mirëkuptimit për bashkëpunim reciprok

arritur ndërmjet:

**Universiteti i Prizrenit**  
përfaqësuar nga Rektori Ramë Vataj

dhe

**KALLXO.com**  
përfaqësuar nga Faik Ispahiu

Prizren, shkurt 2017

## 1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Duke u bazuar në nevojën gjithmonë në rritje për sigurim të përvojës së punës praktike për studentët e Universitetit të Prizrenit (UPZ), palët nënshkruese të këtij memorandumi kanë për qëllim:

- a. ofrimin e mundësive për kryerjen e detyrave për punë praktike dhe studimore për të gjithë studentët e të gjitha fakulteteve dhe degëve të Universitetit të Prizrenit të të gjitha niveleve akademike (Bachelor, Master dhe PhD) në projektet e KALLXO.com;
- b. zhvillimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë për mundësi të ofrimit të shërbimeve për kryerje të punës praktike dhe studimore e cilat do të reflektohen edhe në notimin përfundimtar të studentëve praktikantë nga ana e ligjëruesve, përkatësisht bartësve të lëndës në fakultetet përkatëse;

## 2. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

- a. Palët nënshkruese të këtij Memorandumi në tërësi pranojnë dhe respektojnë natyrën e pavarur të punës së njëri-tjetrit.
- b. Bashkëpunimi i palëve nënshkruese të këtij Memorandumi bazohet në respektimin e plotë të standardeve më të larta profesionale, dispozitave ligjore në fuqi, kodeve të etikës si dhe detyrave dhe obligimeve specifike të palëve të këtij Memorandumi.

## 3. DETYRAT SPECIFIKE

- a. Rektorati i UPZ-së do të sigurohet që:
  - i. T'i njoftojë fakultetet dhe dekanatet për këtë marrëveshje, të bëj shpalljen publike të mundësisë për praktikë për studentë në hapësirat e veta publike dhe t'i njoftojë për mundësitë dhe përparësitë e praktikës në degët përkatëse të të gjitha niveleve akademike;
  - ii. T'i njoftojë fakultetet dhe dekanatet se praktika e realizuar në KALLXO.com mund të njihet si pikë në kredi të lëndëve në lëndët ku kjo është e mundur dhe sipas marrëveshjeve të drejtpërdrejta me dekanatet përkatëse;
  - iii. Të ofrojë përkrahje dhe të jetë në kontakt të rregullt me KALLXO.com për të koordinuar, përcjellë dhe për të nxjerrë mësim nga ky bashkëpunim për avancim të mëtejshëm të procesit të studimeve dhe hulumtimeve akademike;
  - iv. Praktika të koordinohet drejtpërdrejtë me dekanatet duke mos penguar studentët në aktivitetet e tyre universitare.
- b. KALLXO.com do të sigurojë:
  - i. Trajtim të barabartë për të gjithë studentët aplikues për punë praktike në projektet e KALLXO.com;
  - ii. Ofrimin e kushteve të nevojshme për mundësim të kryerjes së detyrave dhe obligimeve të studentëve që kanë në kuadër të praktikës në KALLXO.com;
  - iii. Mentorim dhe përcjellje ditore të punës së secilit praktikant veç e veç nga stafi profesional i KALLXO.com, varësisht nga profili i praktikantit/praktikantes;
  - iv. Evidentimin dhe përgatitjen e raportit individual për angazhimin dhe punën e secilit student/studente veç e veç për nevoja të ligjërueseve dhe dekanateve përkatëse;
  - v. KALLXO.com ruan të drejtën ekskluzive të përzgjedhjes së praktikantëve pas intervistimit të tyre.
- c. Palët nënshkruese të këtij Memorandumi do të përkujdesen që të mobilizojnë të gjitha kapacitetet e tyre njerëzore dhe infrastrukturore për të ofruar angazhim të plotë dhe efikas për realizimin e obligimeve dhe të drejtave të përcaktuara me këtë Memorandum.



- d. Me nënshkrim të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, palët nënshkruese obligohen për të realizuar në tërësi të gjitha të drejtat dhe obligimet e përcaktuara në këtë Memorandum.

#### 4. KOHËZGJATJA DHE AFATET


- a. Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit të zgjasë për periudhë 3 (tre) vjeçare, me vazhdim automatik– përveç nëse palët pajtohen ndryshe.
- b. Zbatimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit mund të ndërpritet nga cilado palë nënshkruese pas njoftimit paraprak me shkrim në afat jo më të shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë.

#### 5. HYRJA NË FUQI

- a. Ky Memorandum i Mirëkuptimit është hartuar në katër (4) kopje identike, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.
- b. Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nënshkruar:

për: Universiteti i Prizrenit

  
\_\_\_\_\_  
Ramë Vataj – Rektori  
Prizren, më 26.04.2017

për: KALLXO.COM

  
\_\_\_\_\_  
Faik Ispahiu – Drejtor Ekzekutiv  
Prizren, më 26/04/2017